



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1071 Prot.

Durrës më, 29/04/2026

V E N D I M

Nr. 62 Datë 29.04 2026

P Ë R

**"MIRATIMIN E FORMATEVE DHE MATERIALEVE NDIHMËSE TEKNIKE TË
DOSJES SË APLIKIMIT PËR TITUJT AKADEMIKË NË UAMD"**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së; bazuar në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik dhe procedurat për fitimin e titujve akademikë në UAMD, neni 19; në Vendimin nr. 5, datë 08.04.2026 të KPPPA-së, relacionin e Drejtorisë Juridike nr. 932/1 prot., datë 16.04.2026, referuar sugjerimeve të anëtarëve të Senatit Akademik në mbledhjen e datës 20.04.2026, si dhe në Relacionin nr. 1060 prot., datë 28.04.2026 të Drejtorisë Juridike, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e formateve dhe materialeve ndihmëse teknike të dosjes së aplikimit për fitimin e titujve akademikë pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Në skedat për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", "Skeda e veprimtarisë" pika II.3 dhe "Profesor" pika II.4 bëhet specifikimi "Kur këta artikuj janë në bashkëautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë".
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - KPPPA
 - Sekretari Teknik i KPPPA-së
 - Qendra për Kërkim dhe Ekselencë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof.Dr. Shkëlqim Fortuzi

